

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reforma Territoriale/ Rama në Elbasan: Asnjë shërbim ekzistues nuk do të shkurtohet! - Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/reforma-territoriale-rama-ne-elbasan-asnje-sherbim-ekzistues-nuk-do-te-shkurtohet/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 20:40:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 20:32:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4ec1e5a6b6b055c90e425619727c6aa99fef863e343d973a274546483ebf70c5
TEKSTI	1126717e29f266a5da7939736967e7d8a1ec613c6e0f700b0be80ec217889b4b
PAMJA	df212063142012ff4dc44250547f064d3780e06a611d0bba84e7bcab6d336da3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	79560395747c56f48e7bf0d1e5993875e05389f2be028c5bb6689d7822146a4a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/79560395747c56f48e7bf0d1e5993875e05389f2be028c5bb6689d7822146a4a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

VIZION FOKUS

Reforma Territoriale/ Rama në Elbasan: Asnjë shërbim ekzistues nuk do të shkurtohet!



13 Shtator 22:32



Kryeministri Edi Rama, gjatë takimit në Elbasan, ka komentuar kundërshtitë për reformën e re administrative-territoriale, duke i krahasuar me debatet e vitit 2015.

Rama tha se frikërat dhe dyshimet janë të njëjta me ato të reformës së parë dhe se bashkimi i njësive vendore solli, sipas tij, më shumë investime dhe përmirësim të shërbimeve.

Ai sqaroi se bashkitë që do të bashkohen nuk do të kthehen në njësi administrative, duke marrë si shembull Prrenjasin me Librazhdin dhe Cërrikun e Belshin me Elbasanin.

Rama theksoi gjithashtu se asnjë nga shërbimet ekzistuese nuk do të shkurtohet, ndërsa synimi, sipas tij, është rritja e kapaciteteve dhe ofrimi i më shumë shërbimeve për qytetarët.



MINUTE PAS MINUTE

MË TË KLIKUARAT



Mesazh me plumba ndaj një gruaje?! Reagon policia për atent...



VIDEO/ Shoferi humb ndjenjat në timon, polici jashtë shërbim...

Rama: Ajo që unë mund t'ju them është që shqetësimet ose kundërshtitë janë njësoj simetrike me shqetësimet dhe kundërshtitë e vitit 2015, kur u bë reforma e parë administrative-territoriale.

Njësoj. Të njëjtat frikëra, të njëjtat dyshime, ngurrime, dhe sot, tani është ndryshimi që bashkohen bashki, nuk bashkohen komuna – bashki. Koha tregoi që ishin frikëra dhe dyshime të pabazuara, sepse të gjitha komunat përfituan më shumë nga bashkimi. Të gjitha shifrat tregojnë që investimet u rritën dhe, në tërësi, shërbimet u përmirësuan.

Parafytyrimi që këto bashki ekzistuese do të kthehen si njësi administrative që keni aktualisht është i gabuar, sepse nuk do të bëhen njësi administrative. Pra, në qoftë se Prrenjas do të bashkohet me Librazhdin, Prrenjas nuk do të jetë njësi administrative e Bashkisë së Librazhdit. Ashtu sikundër Cërriku dhe Belshi, duke u bashkuar me Elbasanin, nuk do të jenë njësi administrative të Elbasanit. Për këtë arsye është krijuar qyteti si njësi administrimi. Pra, është bashkia, është qyteti, pastaj janë njësitë administrative. Dhe faktikisht raporti midis qytetit dhe njërive përkatëse administrative do të ruhet në funksion të mirëkoordinimit të shërbimeve, etj., etj.

Asnjë nga shërbimet ekzistuese nuk do të shkurtohet. Faktikisht, bashkitë ekzistuese kryejnë shumë më pak funksione sesa duhet të kryejnë dhe qëllimi është që të rritet kapaciteti për të kryer më shumë funksione.



Gjirokastrë/ Flakët pranë stallave të lopëve, zjarrfikësit p...



Tragjedi! Përmyset anija me pasagjerë, 129 persona të zhduk...



Parandalohet krimi në Rrogozhinë, i riu kërcënon me kallashn...

/vizionplus.tv

Posted Under: [Anash](#) [Politike](#)

Tagged: [Elbasan](#) [prrenjas](#) [rama](#) [Reforma territoriale](#) [Vizion Plus](#)



NGA E NJËJTA KATEGORI



Droni rus godet trenin pranë kufirit me Poloninë

[më shumë...](#)



Aksident tragjik në Stamboll! Autobusi shpërthen në flakë pas përplasjes, 2 viktime dhe 8 të plagosur

[më shumë...](#)



Tragjedi! Përmyset anija me pasagjerë, 129 persona të zhdukur

[më shumë...](#)



Fitore me vuajtje për Bayern, vendos Harry Kane

[më shumë...](#)

Leave a Reply

Your email address will not be published. Required fields are marked *

Comment

*

Name *

Email *

Website

☐ Save my name, email, and website in this browser for the next time I comment.

☐ Notify me of follow-up comments by email.

☐ Notify me of new posts by email.

Post Comment